



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 141, datë 28.07.2021**

**PËR**

**MARRJEN E MASAVE NDAJ “ALBSIG INVEST-SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE ASETEVE TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2 dhe pikës 21, si dhe nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 80, 81, 102 dhe 103 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Bazuar në nenin 80, pika 2 dhe nenin 81, pika 1, shkronja b), të Ligjit nr. 10197 datë, 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, urdhërohet shoqëria “Albsig Invest-Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive” sh.a.:**
  - a. Të zbatojë detyrimin për njoftimin e anëtarëve të fondit, 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit, sipas nenit 4, të Rregullores nr. 126 datë 07.12.2010 “Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar”;**
  - b. Të njoftojë anëtarët në periudha të rregullta kohore dhe të paktën çdo 30 ditë, duke i pajisur në kohë me kredencialet e llogarisë së tyre në fondin e pensionit;**
  - c. Të rishikojë përmbajtjen e kontratës së fondit të pensionit ndërmjet punëdhënësit dhe shoqërisë administruese duke përfshirë rekomandimet sipas raportit të inspektimit;**
  - d. Të marrë çdo masë tjetër që lidhet me korrigjimin e shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimit.**
- 2. Bazuar në nenin 81, pika 3, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e pensionit vullnetar”, shoqëria të zbatojë urdhërin e mësipërm duke raportuar në Autoritet brenda datës 30 shtator 2021.**

3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**